

KONTRATE SHITJE KUOTASH

Në Tiranë, sot në datën 15/11/2022 (dymijë e njëzetë e dy):

Z. Ledjon Agalliu, i datëlindjes 18/11/1992, lindur në Berat dhe banues në Berat, shtetas Shqiptar, madhor, me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i Letërnjoftimit Pasaporte nr. Personal J21118055U ; referuar më poshtë si "Shitësi";

Z. Francesco Carbone, i datëlindjes 10/02/1970, lindur në Itali dhe banues në Zvicer, shtetas Zvicerian, madhor, me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i Letërnjoftimit Pasaporte nr. Personal E2910489 ; referuar më poshtë si "Shitësi";
dhe

Z. Nikolin Ngjela, i datëlindjes 04/05/1992, lindur në Korçe dhe banues në Tirane, shtetas Shqiptar, madhor, me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i Letërnjoftimit me nr. Personal J20504061E ; referuar më poshtë si "Blerësi".

MEQËNËSE ekzistojnë faktet:

Z. Ledjon Agalliu, është ortak i shoqërisë "LEKO TECH" SHPK, shoqëri tregtare e të drejtës shqiptare, me NIPT(NUIS) L82107028B, dhe zotëron 32.5% të kuotave të shoqërisë "LEKO TECH" SHPK,

Z. Francesco Carbone, është ortak i shoqërisë "LEKO TECH" SHPK, shoqëri tregtare e të drejtës shqiptare, me NIPT(NUIS) L82107028B, dhe zotëron 37.5% të kuotave të shoqërisë "LEKO TECH" SHPK,

Z. Ledjon Agalliu, dëshiron ti shesë 5% të kontributeve totale të shoqërisë, ortakut të ri, **Z. Nikolin Ngjela**,

Z. Francesco Carbone, dëshiron ti shesë 5% të kontributeve totale të shoqërisë, ortakut të ri, **Z. Nikolin Ngjela**, sipas kushteve të mëposhtme:

Z. Nikolin Ngjela dëshiron të blejë nga **Z. Ledjon Agalliu** 5% të kuotave totale të shoqërisë "LEKO TECH" SHPK;

Z. Nikolin Ngjela dëshiron të blejë nga **Z. Francesco Carbone** 5% të kuotave totale të shoqërisë "LEKO TECH" SHPK, sipas kushteve të mëposhtme.

Nisur sa më sipër, palët, me vullnet të lirë dhe të plotë, hartojn këte "Kontratë shitje kuotash", me përmbajtjen si më poshtë :

Neni 1

Qëllimi i kontratës

- Qëllimi i kësaj kontrate është transferimi i 10 % të kontributeve totale të shoqërisë "LEKO TECH" SHPK, nga shitësit, tek blerësi.
- Kjo kontratë shërben për përcaktimin e kriterëve, procedurave dhe mënyrës së tranferimit të pronësisë dhe pagesës përkatëse lidhur me këtë transferim në përputhje me legjislacionin përkatës.

Neni 2

Objekti i kontratës

-Nëpërmjet kësaj kontrate, shitësit transferon në favor të blerësve 10% të kontributeve totale të shoqërisë si më poshtë të përcaktuara:

- **Z.Ledjon Agalliu**, dëshiron ti shesë 5 % të kontributeve totale të shoqërisë, ortakut të ri, **Z. Nikolin Ngjela**, sipas kushteve të mëposhtme:
- **Z.Francesco Carbone**, dëshiron ti shesë 5% të kontributeve totale të shoqërisë, ortakut të ri, **Z. Nikolin Ngjela**:

Neni 3

Çmimi dhe menyra e pagimit

-Të dyja palët kanë rënë dakort midis tyre që çmimi i shitjes të kontributeve që shitësi transferon në favor të blerësit do të jetë në vlerën nominale të kuotave, konkretisht:

- **Z.Nikolin Ngjela** i ka paguar **Z.Ledjon Agalliu**, 5 lek për kuotën që përfaqëson 5 % të kapitalit të shoqërisë;
- **Z. Nikolin Ngjela** i ka paguar **Z.Francesco Carbone**, 5 lek për kuotën që përfaqëson 5% të kapitalit të shoqërisë;

-Po ashtu, të dyja palët deklarojnë se shumatat e mësipërme i është shlyer përkatësisht **Z. Ledjon Agalliu** dhe **Z. Francesco Carbone**, përpara nënshkrimit të kësaj kontrate, dhe se palët nuk kanë asnjë pretendim financiar kundrejt njëri-tjetrit.

Neni 4

Përgjegjësitë dhe garancitë e palëve

Shitësit, nëpërmjet kësaj kontrate shitje kuotash garanton si më poshtë:

- a) se është i vetmi titullar i ligjshëm i kontributeve që po transferohen me këtë kontratë shitje;
- b) se kontributet objekt shitje janë plotësisht të lira nga çdo barrë, detyrim, të drejta reale apo çdo lloj kufizimi tjetër;
- c) se transferimi i këtyre kontributeve në drejtim të blerësve është bërë në pajtim të plotë me ligjin tregtar në fuqi dhe dispozitat statutore;
- d) se shoqëria ka zhvilluar aktivitetin e saj në konformitet me ligjin;
- e) të gjitha detyrimet financiare mbi pjesën e kuotave të shitura në këtë kontratë, që burojnë nga akte të ndryshme juridike apo nga veprimtari tregtarë të shoqërisë, të kryera prej saj apo ortakëve dhe/ose administratorit të saj përpara datës së nënshkrimit të kësaj kontrate shitje kuotash, detyrime këto të cilat mund të jenë kërkuar përpara kësaj date apo mund të kërkojnë në një të ardhme pas nënshkrimit të kësaj kontrate, do të jenë në përgjegjësinë e plotë dhe garancinë e palëve shitëse në mënyrë individuale, duke i shlyer ato personalisht, apo duke i dëmshpërblyer me kapitalet e tyre që zotërojnë në këtë shoqëri.

Blerësit, nëpërmjet kësaj kontrate shitje kuotash deklarojnë si më poshtë:

- f) nuk kanë dhe nuk mbajnë asnjë përgjegjësi ligjore kundrejt palëve të treta apo edhe vetë ortakëve midis tyre, për të gjitha veprimet e kryera nga ana e shoqërisë, ortakëve të saj apo edhe administratorëve, nga momenti i krijimit të shoqërisë deri në momentin e nënshkrimit të kësaj kontrate shitje kuotash,

- g) nuk kanë dhe nuk mbajnë asnjë përgjegjësi financiare kundrejt palëve të treta apo edhe vetë ortakëve midis tyre, për të gjitha veprimet e kryera nga ana e shoqërisë, ortakëve të saj apo edhe administratorëve, nga momenti i krijimit të shoqërisë deri në momentin e nënshkrimit të kësaj kontrate shitje kuotash,

NENI 5

Efektet e kontratës

- Kjo kontratë ka fuqinë e ligjit për palët nga momenti i nënshkrimit të saj dhe mund të ndryshohet vetëm me marrëveshje me shkrim dy-palëshe.
- Kontrata ka efekt për palët e treta në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

NENI 6

Informacioni konfidencial

- Palët detyrohen të mbajnë konfidencial të gjithë dokumentacionin, të dhënat dhe cdo informacion të përfituar gjatë marrëdhënies së tyre në shoqëri apo dhe referuar marrëdhënies konkrete të krijuar me këtë kontratë.

NENI 7

Transferimi i të drejtave

- Menjëherë mbas nënshkrimit të palëve, kontrata do të depozitohet dhe regjistrohet nga blerësia pranë regjistrimit tregtar të QKB.
- Me nënshkrimin e kësaj kontrate, kapitali i shoqërisë "Leko Tech" SHPK do t'i përkasë ortakëve, si më poshtë:

- Z. Ledjon Agalliu, zotërues i kuotës, që përfaqëson 27.5 % të kapitalit të Shoqërisë "LEKO TECH" SHPK; në vlerë kapitali 27.5 LEKË (njetzet e shtate pike pesë) lek.
- Z. Francesco Carbone, zotërues i kuotës, që përfaqëson 32.5 % të kapitalit të Shoqërisë "LEKO TECH" SHPK; në vlerë kapitali 32.5 LEKË (tridhjet e dy pike pesë) lek.
- Z.Luigi Sani, zotërues i kuotës, që përfaqëson 10 % të kapitalit të Shoqërisë "LEKO TECH SHPK, në vlerë kapitali 10 LEKË (dhjete) lek.
- Z.Elton Ngjela, zotërues i kuotës, që përfaqëson 10 % të kapitalit të Shoqërisë "LEKO TECH SHPK, në vlerë kapitali 10 LEKË (dhjete) lek.
- Z.Nikolin Ngjela, zotërues i kuotës, që përfaqëson 20 % të kapitalit të Shoqërisë "LEKO TECH SHPK, në vlerë kapitali 20 LEKË (Njetzet) lek.

NENI 8

Ligji i aplikueshëm, zgjidhja e mosmarrëveshjeve

- Kontrata është hartuar në përputhje me Legjislacionin tregtar në fuqi.
- Blerësi dhe shitësi angazhohen të bëjnë cdo përpjekje për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve apo konfliktet të mundshme që mund të krijohen midis tyre, lidhur me këtë kontratë nëpërmjet negociimeve të drejtëpërdrejta.
- Nëse palët dështojnë në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve apo konflikteve midis tyre, çështja do t'i nënshtrohet juridiksionit gjyqësor përkatës.


NENI 9

Dispozita përfundimtare

- Kjo kontratë është hartuar në 4 (katër) kopje, në gjuhën Shqipe me vlerë të njëjtë ligjore nga një për secilën palë, e cila ju lexua me zë të lartë e të qartë palëve

-Palët deklaruan se e dëgjuan, e kuptuan dhe meqënëse kontrata është hartuar në përputhje me vullnetin e tyre dhe ligjin, e nënshkruan personalisht dhe pa vërejtje përpara meje noterit.

Ortaku Z. Francesco Carbone, shtetas Italo-Zvicerian, morën dijeni për përmbajtjen e kësaj kontrate nga përkthimi i bërë në gjuhën Italiane nga z.Bledar Brami.



PALËT KONTRAKTORE

SHITËSI

BLERËSI

Z. Ledjon Agalliu



Z. Francesco Carbone



Z. Nikolin Ngjela

